



REPubliKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
KOMISIONI PER NDIHMEN JURIDIKE



KENI NEVOJË PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS?



Ky publikim, është mundësuar me mbështetjen financiare të AMSHC. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorit, opinioni i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i AMSHC.

Cilët persona përfitojnë Ndihmë Juridike nga Shteti?

Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë personat, të cilët:

-kërkojnë të mbrohen me avokat në procesin penal
në të gjitha fazat e tij dhe mund të zgjedhin një
avokat për shkak të pamundësive financiare.

-kanë nevojë për Ndihmë Juridike në çështjet civile ose administrative dhe nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar. Në këtë rast, që personi ta përfitojë Ndihmën Juridike duhet të vërtetojë se përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t'u përfshirë në to.

-Ndihmën Juridike e përfitojnë gjithë të miturit, për të cilët mbrojtja në procedimin penal dhe në gjykim është e detyrueshme me ligj.

- Ndihma Juridike mund të kërkohej para, gjatë dhe pas zhvillimit të procesit gjyqësor.

Si të kontaktojme Avokatin e Ndhmës Juridike?

Në bazë të ligjit Ndhima Juridike parësore dhe Ndhima Juridike dytësore jepen vetëm nga personat që ushtrojnë profesionin e avokatit.

Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike përcaktojnë listën e avokatëve që autorizohen, të japin ndihmë juridike, si dhe vendin e shtrirjes së veprimtarisë së tyre.

1. Lista e avokatëve, që autorizohen për dhënien e ndihmës juridike, bëhet publike prane 12 Dhomave të Avokatisë në të gjithë vendin: Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Fier, Lezhë, Lushnjë, Elbasan, Sarandë, Gjirokastër, Korçë dhe Berat.
2. Organizatat jofitimprurëse gjithashtu, që janë të specializuara në fushën e dhënies së Ndihmës Juridike janë parashikuar nga ligji të japin Ndihmë Juridike me avokatë.

Disa nga organizatat jo fitimprurëse me kapacitete për të ofruar Ndihmë Juridike janë: Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave të Integruara, Tiranë, Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare, Tiranë, Fondacioni i Personave me Aftësi të Kufizuara, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, etj.

Si do ankohe mi nëse Ndihma Juridike
refuzohet ose nuk është efektive?

Çdo person i interesuar gëzon të drejtën e paraqitjes së kërkesës ankimore para Kryetarit, Komisionit të Ndihmës Juridike ose para Gjykatës.

Komisioni ka kompetencën të verifikojë dhe kontrollojë cilësinë e Ndhmës Juridike për rastet konkrete dhe, në bazë të rezultateve, ka të drejtë të zgjidhë kontratën e shërbimit me avokatin e autorizuar për dhënien e ndihmës juridike.

>> >> >> >> >> >> >> >> >> >>

Ndihma Juridike është instrumenti më efikas për ti garantuar individit aksesin në drejtësi.
Përmes Ndhimës Juridike çdo individ në pamundësi financiare mund të marrë mbështetjen e nevojshme për realizimin e të drejtave të tij.

Aksesi në drejtësi është i lidhur ngushtë me ofrimin Ndihmës Juridike Falas. Koncepti i Ndihmës Juridike¹ përfshin tërësi shërbimesh ligjore që i ofrohen individëve në nevojë. Aksesi në drejtësi ndër të tjera është akses në shërbime ligjore që përfshijnë informacion, këshillim, përkatitje dokumentesh dhe përfaqësim.

1 Kur përmendim termin “Ndihmë” Juridike nënkuptojmë Ndihmën Juridike Falas

**Nëse ju kërkoni informacione të
mëtejshme ose këshillime, Ju lutem na kontaktoni në :
SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË
Rruga “Sami Frashëri”
4 kullat seksioni III, Ap 1A
Tiranë, Shqipëri
Tel: 00 355 4 253 114, Tel/Fax: 00355 4 258 442
www.tlas.org.al**



NDIHMA JURIDIKE SYNON RRITJEN E AKSESIT NE DREJTESI

Çfarë kuptojmë me Ndihmë Juridike?

Me Ndihmë Juridike kuptojmë ofrimin e shërbimit ligjor falas për individët në pamundësi financiare për të zgjidhur dhe realizuar të drejtat e tyre.

Ligji për Ndhmën Juridike përcakton kushtet, llojin, mënyrën dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti, për mbrojtjen e lirive e të të drejtave themelore të individit, si dhe të interesave të tjerë të ligjshëm të tij.

Kush janë Parimet themelore të Ndhmës Juridike?

Dhënia e ndihmës juridike nga shteti mbështetet në parimet:

- e barazisë së të drejtave për të gjithë individët, që përfitojnë nga ndihma juridike;
- e profesionalizmit të personave, që japin ndihmën juridike;
- e cilësisë, efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimit të ndihmës juridike;
- e ruajtjes së konfidencialitetit;
- e papranueshmërisë së konfliktit të interesit.

Kush e Administron Dhënien e Ndhmës Juridike nga Shteti?

Përgjegjës për dhënien e ndihmës juridike nga shteti, është Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike.

Ministria e Drejtësisë:

- të zhvillojë politikën shtetërore;
- të ndihmojë në përgatitjen e akteve të nevojshme ligjore/nëligjore, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Komisionin Shtetëror për Ndhmën Juridike;
- të kujdeset për zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore dhe ndihmon në vlerësimin e cilësisë së ndihmës juridike të dhënë;
- të përgatis projektbuxhetin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Dhoma Kombëtare e Avokatisë:

- të përcaktojë kriteret për përzgjedhjen e avokatëve, që do të japin ndihmë juridike;
- të përcaktojë kriteret për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të dhënë nga avokatët;

- të marr masa disiplinore ndaj avokatëve, që japin ndihmë juridike, në përputhje me ligjin nr.9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike do të:

- zbatojë politikën shtetërore në dhënien e ndihmës juridike për individët;
- menaxhojë buxhetin e dhënë për ofrimin e ndihmës juridike nga shteti;
- miratojë rregullat e caktimit të avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse, që do të ofrojnë ndihmën juridike dhe kujdeset për zbatimin e tyre;
- lidhë kontratat e shërbimit me avokatët, zyrat e avokatisë dhe organizatat jofitimprurëse, që do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike;
- vendosë masën e shpërbimit të avokatëve në ofrimin e ndihmës juridike ndaj individëve,
- përcakton dhe rishikon standardet e ndihmës juridike, si dhe kujdeset për trajnimet profesionale për avokatët që japin këtë ndihmë;
- vendosë kriteret, në bazë të të cilave do të vlerësohet cilësia e shërbimit të ndihmës juridike të dhënë;

- mban të dhëna për personat, që përfitojnë ndihmë juridike dhe boton, në fund të çdo viti, buletin statistikor;
- cakton përparësitë për çështjet, për të cilat ofrohet ndihmë juridike,
- bashkërendon sistemin e ndihmës juridike, duke përfshirë ofrimin e saj në të gjitha format.

Kush janë format e Ndhmës Juridike?

1. Forma e Ndhmës Juridike parësore, që është dhënia e informacionit për sistemin ligjor, për të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit, për aktet normative në fuqi, mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit, në proceset gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, për hartimin e dokumenteve juridike apo në forma të tjera.
2. Forma e Ndhmës Juridike dytësore që është dhënia e shërbimeve të këshillimit, përfaqësimit apo mbrojtjes në proceset gjyqësore penale, proceset gjyqësore civile dhe administrative, si dhe përfaqësimit para organeve administrative shtetërore.
3. Ndhma juridike jepet edhe nëpërmjet edukimit ligjor të publikut, përmes shërbimit ligjor falas në komunitet me klinika lëvizëse, publikime, fushata televizive dhe në mediane shkruar, duke u përqëndruar me vëmendje të veçantë në problemet e grupeve më në nevojë.